

## EFFECTS OF VAT RATE CHANGES ON THE BUDGET REVENUES OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Vehbi Imeri**

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, [vehbi.imeri@hotmail.com](mailto:vehbi.imeri@hotmail.com)

**Abstract:** This paper is designed to provide a scientific analysis on the impact of VAT rate changes on the Budget Revenue of the Republic of Kosovo, these changes entered into force on 01 September 2015, the legal basis of which The amendments are Law no. 05 / L - 037 on Value Added Tax that is part of the fiscal package adopted in the 5th (fifth) legislature of the Assembly of the Republic of Kosovo. The adoption of this fiscal package and the entry into force of VAT rate changes are as follows: Value Added Tax (VAT) on 01.09.2015 increases from 16% tax rate as it was from 01.01.2009 to 31.08. 2015 at the rate of 18% for both services and luxury items (not required) that have a place of supply in the Republic of Kosovo, while for consumer items such as drinking water, electricity supply, cereals for planting, cereal products, cooking oils, salts, milk, eggs, textbooks, information technology equipment, drugs, medical equipment, ... VAT is reduced from the previous rate of 16% to 8%. whereas, with respect to the rate of 0% and those exempted, they are foreseen and described in the relevant Articles in Law no. 05 / L - 037 On Value Added Tax, Another novelty that this fiscal package also includes VAT exemption when importing Raw Materials and Fixed Assets, no change in VAT rate on health services and hospital treatments as well as education at all levels of education. This paper will therefore analyze whether it has had an impact on increasing budget revenues or decreasing budget revenues with these changes to the fiscal package related to VAT.

**Keywords:** Changes, Taxes, VAT, Budget Revenue

## EFEKTET E NDRYSHIMEVE TË NORMËS SË TVSH-SË NË TË HYRAT E BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**Vehbi Imeri**

Kolegji Biznesi Prishtinë, Kosovë, [vehbi.imeri@hotmail.com](mailto:vehbi.imeri@hotmail.com)

**Përmbledhje:** Ky punim është i hartuar me qëllim të dhënjes së një analize shkencore lidhur me ndikimin e ndryshimeve të normës së TVSH-së në të Hyrat Buxhetore të Republikës së Kosovës, këto ndryshime kanë hyrë në fuqi me 01 Shtator 2015, baza ligjore e këtyre ndryshimeve është Ligji Nr. 05/L - 037 Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar që është pjesë e paketës fiskale e miratuar në legjislaturën e 5 (pestë) të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Miratimi i kësaj pakete fiskale dhe hyrja në fuqi e ndryshimeve të normës së TVSH-së përshkruhet si më poshtë vijon: Tatimi në Vlerën e Shtuar (TVSH) më 01.09.2015 rritet nga norma tatimore 16% sa ishte prej 01.01.2009 deri 31.08.2015 në normën 18 % si për shërbime ashtu edhe për artikuj të luksit (që nuk janë të domosdoshëm) të cilat vendin e furnizimit e kanë në Republikën e Kosovës, ndërsa për artikujt e konsumit siq janë uji i pijes, furnizimi me energji elektrike, drithërat për mbjellje, prodhimet nga drithërat, vajrat për gatim, kripërat, qumështi, vezët, librat shkollorë, pajisjet e teknologjisë informative, barnat, pajisjet medicinale,... TVSH është zbritur nga norma e mëhershme prej 16 % sa ka qenë në normën 8 %, ndërsa sa i përket normës me 0% dhe atyre të liruara të njejtat janë të parapara dhe të përshkruara në Nenet përkatëse në Ligjin Nr. 05/L - 037 Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar, risi tjetër që kjo paketë fiskale parashah është edhe lirimi i pagesës së TVSH-së gjatë importimit të Lëndës së pare dhe Mjeteve themelore, nuk ka ndryshime të normës së TVSH-së për shërbimet shëndetësore dhe trajtimet spitalore si dhe për arsimimin në të gjitha nivelet e shkollimit. Në këtë punim pra do të analizohet se a ka pasur ndikim në rritjes e të hyrave buxhetore apo në rënjen e të hyrave buxhetore me këto ndryshime të paketës fiskale që lidhet me TVSH-në.

**Fjalët kyqe:** Ndryshimet, Tatimet, TVSH, Të Hyrat Buxhetore

### 1. HYRJE

The tax which each individual is bound to pay ought to be certain, and not arbitrary. The time of payment, the manner of payment, the quantity to be paid, ought all to be clear and plain to the contributor, and to every other person. (Smith Adam, 1998, p.1104).

Taksa të cilën çdo individ është i detyruar të paguaj duhet të jetë e sigurt dhe jo arbitrare. Koha e pagesës, mënyra e pagesës, vlera që duhet paguar duhet që gjithnjë të jenë të qarta dhe të thjeshta për kontribuesit dhe çdo person tjetër. (Smith Adam, 1998, p.1104).

Duke pasur parasysh rëndësinë e pagesës së tatimeve nga ana e tatimpaguesëve pasi që të njëjtat paraqesin burimin kryesor të të hyrave publike me të cilat shteti mbulon shpenzimet publike.

Efektet e ngritjes së normës tatimore janë se ato ia zvogëlojnë fuqinë blerëse obliguesit tatimor duke shkaktuar efekte të natyrës sociale, ekonomike, financiare dhe morale, ndërsa efektet e kundërta janë nëse normat tatimore zvogëlohen.

Faktorë me rëndësi në zhvillimin ekonomik të një vendi janë politikatat tatimore të cilat me efektet e tyre përmirësojnë mirëqenjen shoqërore.

Analiza e këtyre efekteve të ndryshimit të normës tatimore të TVSH-së të cilat ndryshuan dhe hynë në fuqi duke filluar prej 01.09.2015, paraqesin një qasje me rëndësi se si ato ndikuan në të hyrat në përgjithësi dhe shtrohen një varg pyetjesh të cilat kërkojnë një përgjigje me një hulumtim shkencor.

Studimi bazohet në të hyrat e realizuara nga Doganat e Kosovës si dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

## 2. TË HYRAT E REALIZUARA NË VITET 2016, 2017 DHE 2018

Duke u bazuar në të dhënat e marrura nga burimet zyrtare publikuar nga Ministria e Financave të Kosovës lidhur me të hyrat e realizuara në vitet përkatësë (shih: tab. 1).

Tab. 1 (Raporti vjetor financiar 2018 – Ministria e Financave të Republikës së Kosovës, 04.04.2019 fq. 13).

<u>Përshkrimi</u>	<u>2018</u> <u>'000 €</u>	<u>2017</u> <u>'000 €</u>	<u>2016</u> <u>'000 €</u>
TVSH-ja e brendshme	213,131	198,341	179,203
TVSH-ja shtyrë	-	-	90
TVSH-ja kufitare	585,889	557,776	514,461
<b>Gjithsej</b>	<b>799,020</b>	<b>756,117</b>	<b>693,754</b>

Duke u nisur nga fakti se më 01.09.2015 kanë hyrë në fuqi këto ndryshime në normën tatimore të cekur më lartë, analiza e këtyre efekteve do të bëhet duke bërë krahasimin në vijë horizontale dhe duke marrë për bazë vitin 2016.

Me përdorimin e analizës krahasuese horizontale e cila ka për qëllim të përcaktojë rritjet apo uljet që kanë ndodhur në periudhat të cilat po analizohen fitojmë një pasqyrë të qartë rreth ndikimit të këtyre efekteve.

Tab.2 Bazohet në të dhënat nga tabela Tab.1 nxjerrim këto përfundime rreth rritjes dhe rënjes së realizimit të të hyrave nga Doganat e Kosovës.

Përshkrimi	Vitet			Rritja 2017 /2016		Rritja 2018 /2016		Rritja 2018 /2017	
	2016	2017	2018	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
TVSH e mbledhur nga Doganat e Kosovës	514 461 000.00	557 776 000.00	585 889 000.00	43 315 000.00	8.42	71 428 000.00	13.88	28 113 000.00	5.04

Tab.3 Bazohet në të dhënat nga Tab.1 nxjerrim këto përfundime rreth rritjes dhe rënjes së realizimit të të hyrave nga ATK

Përshkrimi	Vitet			Rritja 2017 /2016		Rritja 2018 /2016		Rritja 2018 /2017	
	2016	2017	2018	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
TVSH e mbledhur nga ATK	179 203 000.00	198 341 000.00	213 131 000.00	19 138 000.00	10.68	33 928 000.00	18.93	14 790 000.00	7.46

Tab.4 Bazohet në të dhënat e marrura nga Raporti vjetor i Administratës Tatimore të Kosovës Janar – Dhjetor 2018 faqe 19 nxjerrim këto përfundime rreth rritjes dhe rënjes së realizimit të të hyrave nga ATK

Llogaritë tatimore	Të hyrat për periudhën Janar-Dhjetor/2016-2018		
	2016	2017	2018
1	2	3	4
Tatimi mbi vlerën e shtuar	180,363,401	196,635,189	215,184,335.1

Ndryshimet në raportimin e të hyrave nga TVSH e inkasuar brenda vendit në mes të Raprtit të Ministrisë së Financave dhe ATK-së nuk mund të argumentohet në këtë analizë studimore.

Tab.5 paraqet raportin e strukturës së TVSH-së sipas burimit të të hyrave të inkasuara

Përshkrimi	Vitet			Struktura 2016	Struktura 2017	Struktura 2018
	2016	2017	2018	%	%	%
TVSH e mbledhur nga Doganat e Kosovës	514 461 000.00	557 776 000.00	585 889 000.00	74.17	73.77	73.33
TVSH e mbledhur nga ATK	179 203 000.00	198 341 000.00	213 131 000.00	25.83	26.23	26.67
Totali	693 664 000.00	756 117 000.00	799 020 000.00	100.00	100.00	100.00

Duke u bazuar në faktin se objekt studimi kemi vetëm efektet e ndryshimit të normës së TVSH-së atëherë përqëndrimi ynë përcaktohet vetëm në këtë analizë dhe ate si vijon:

1. **TVSHK** në vitin 2017 shënon rritje të të hyrave nga TVSH e inkasuar nga Doganat e Kosovës prej 8.42 % në raport me vitin 2016 apo shprehur në vlerë 43,315,000.00 Euro, në vitin 2018 shënon rritje të të hyrave prej 13.88 % në raport me vitin 2016 apo shprehur në vlerë 71,428,000.00 Euro, ndërsa në vitin 2018 shënon rritje të të hyrave prej 5.04 % në raport me vitin 2017 apo shprehur në vlerë 28,113,000.00 Euro. TVSH e inkasuar në kufi nga Doganat e Kosovës ka shënuar rritje të theksuar vetëm në vitin e parë, kjo rritje rezulton nga baza e importit, ndërsa në vitin 2018 kjo dinamikë e rritjes pëson ulje prej 3.38 % që do të thotë se janë inkasuar të hyra buxhetore më të ulëta, kjo është edhe si pasojë e aplikimit të taksës 100 % ndaj mallrave me origjinë nga Serbia dhe Bosna e Hercegovina.

Rritja e normës së TVSH nga 16 % në 18 % nuk ka ndikuar në uljen e vlerës së importeve të mallrave, “vlerat e importeve të mallrave në vitin 2016 është 2,598,700,000.00 Euro, në vitin 2017 është 2,842,600,000.00 Euro dhe në vitin 2018 është 3,106,700,000.00 Euro” “Bruto Produkti Vendor 2008 – 2018” Agjensioni i Statistikave të Kosovës, faqe 11.

Po qëse analizojmë trendin e rritjes së importeve të mallrave në njërin anë dhe zvogëlimin e trendit të inkasimit të TVSH në import për vitin 2017 në krahasim me vitin 2016 mund të konstatojmë se efekti i ndryshimit të normës së TVSH-së nga 16 % në 8 % ka ndikuar në këtë trend, kemi pasur një rritje të vlerës së importeve prej 9,38 %, rritja e importeve në vitin 2018 në krahasim me vitin 2016 kemi pasur një rritje të vlerës së importeve prej 19,59 %, rritja e importeve në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 kemi pasur një rritje të vlerës së importeve prej 9,29 %, për derisa trendi i rritjes së importeve ka qenë thuaja se në nivelin e njejtë apo një rënje të ulët prej 0,09 %, ndërsa ulja e inkasimit të TVSH-së në kufi ka pasur ulje në 3.38 %, nga kjo mund të konstatojmë se tre faktorë kanë qenë kyq në lartësin e të hyrave buxhetore nga inkasimi i TVSH-së në kufi nga ana e Doganave të Kosovës, këta janë:

- Ulja e normës tatimore të TVSH-së nga 16 % në 8 %,
- Marrëveshja e stabilizim asociimit me vendet e BE-së për heqjen e taksës doganore apo uljen e normës së sajë, ulja e normës së taksës doganore ka ndikuar pasi që e njejtja së bashku me vlerën e furnizimit të mallit përcakton bazën për përlllogaritjen e TVSH-së në import dhe
- Taksa 100 % në prodhimet me origjinë nga Serbia dhe Bosna e Hercegovina.

Struktura e pjesëmarrjes së të hyrave të inkasuara nga TVSH-ja në kufi nga Doganat e Kosovës ka një rënje të lehtë apo 0.40 % në vitin 2017 në raport me vitin 2016, 0.84 % në vitin 2018 në raport me vitin 2016 dhe 0.44 % në vitin 2018 në raport me vitin 2017, ndërsa struktura e inkasimit të TVSH-së vendore e inkasuar nga ATK ka këtë trend të rritjes në proporcion të njejtë me uljen e inkasimit në kufi.

2. **TVSHV** në vitin 2017 shënon rritje të të hyrave nga TVSH e inkasuar nga ATK prej 10.68 % në raport me vitin 2016 apo shprehur në vlerë 19,138,000.00 Euro, në vitin 2018 shënon rritje të të hyrave prej 18.93 % në raport me vitin 2016 apo shprehur në vlerë 33,928,000.00 Euro, ndërsa në vitin 2018 shënon rritje të të hyrave prej 7.46 % në raport me vitin 2017 apo shprehur në vlerë 14,790,000.00 Euro. TVSH e inkasuar brenda vendit nga ATK ka shënuar rritje të theksuar vetëm në vitin e parë.

Po qëse analizojmë trendin e inkasimit të TVSH vendore për vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 kemi pasur një rritje prej 7,46 %, apo në vitin 2017 në raport me vitin 2016 ku kemi një rritje prej 10.68 %, nga kjo vërehet se si pasojë e kësaj rritjeje të normës së TVSH nga 16 % në 18 % dhe uljes së normës tatimore nga 16 % në 8 % si dhe zgjerimit të listës së mallrave me 0 % ka pasur efekt në këtë rënje të inkasimit të TVSH vendore prej 3.22 %.

Faktorët që kanë ndikuar në zvogëlimin e inkasimit të TVSH vendore janë:

- Ulja e normës tatimore të TVSH-së nga 16 % në 8 %
- Zgjerimi i listës së mallrave me normë TVSH-së 0 %
- Aplikimi i ngarkesës së kundërt për TVSH në ndërtimtari.

- Prodhimi i kufizuar i produkteve të cilat i janë nënshtruar taksës 100 % që kanë qenë me origjinë nga Serbia dhe Bosna e Hercegovina brenda Kosovës për zavendësimin e tyre në tregun vendorë.

Nga kjo analizë nxjerrim këto përfundime:

1. Paketa fiskale e vitit 2015 nuk ka prodhuar efekte negative në realizimin e të hyrave nga tatimet në Republikën e Kosovës në përgjithësi, por sa i përket TVSH-së ka krijuar një rënje të trendit të rritjes së shumës tatimit së inkasuar nga ky burim.
2. Rritja e inkasimit të TVSH-së vetëm mbrenda teritorit të Republikës së Kosovës, pra nga ATK ka filluar të ketë efekte pozitive dhe ky trend i lehtë i rritjes sillet prej 0.40 % sa ishte në vitin 2017 e deri te 0.44 % të ketë arritur në vitin 2018.
3. Paketa fiskale ka ndikuar te një numër i madh i tatimpaguesve në ngritjen e vetëdijes së tyre, se tatimet duhet deklaruar dhe paguar ashtu siq janë të parapara me ligj dhe pa vonesa. Në librin e tij “Financat Publike” autori Harvey S. Rosen citon një deklaratë të Gjykatë Supreme të SHBA ku thuhet: “*Pushteti për të vendosur tatime është një pushtet i fuqishëm, mbi të cilin bazohet e gjithë fabrika kombëtare. Ky pushtet është kaq i domosdoshëm për ekzistencën dhe prosperitetin e një kombi, sa është edhe ajri për njeriun. Nuk është vetëm pushteti për të shkatërruar, por edhe pushteti për të mbajtur gjallë*” (Financa Publike Harvey S. Rosen, Tirane 2003 fq 305).
4. Paketa fiskale ka krijuar kushte shumë të favorshme për inkurajimin e investimeve vendore dhe të huaja, për të arritur efektet e saj e njejtë duhet të përkrahet edhe nga aspekti i ofrimit të garancive tjera institucionale që e mundësojnë realizimin e këtyre synimeve.
5. Politika fiskale e vitit 2015 e vënë Republikën e Kosovës në mesin e vendeve më të favorshme për të bërë biznes.
6. Me anë të kësaj pakete fiskale shteti realizon qëllimet e veta pra, “*Qëllimi i tatimit (i të tatuarit) është mbledhja e mjeteve financiare për shtetin dhe organet e tjera publike të cilat janë të nevojshme për financimin e funksioneve të tyre. Ky është edhe qëllimi fiskal i tatimit.*” (Financat Publike, Sabahudin Komoni, Prishtinë 2008, fq 47).

#### LITERATURA

- Komoni, S., (2008) *Financat Publike*, Prishtinë 2008  
Rosen, S. H., (2003) *Financa Publike*, Tiranë 2003  
Smith, A., *The Wealth of Nations*, ElecBook Classics  
*Raporti vjetor financiar 2018* – Ministria e Financave të Republikës së Kosovës, Prishtinë 2019  
*Raporti vjetor i Administratës Tatimore të Kosovës Janar – Dhjetor 2018*, Prishtinë 2019  
*Bruto Produkti Vendor 2008 – 2018*, Agjensioni i Statistikave të Kosovës, Prishtinë 2019  
Ligji Nr. 05/L - 037 Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar